



Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prodato Received / Delivery	29.06.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIAPMSH/COC	3811/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.379/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.216/20 të datës 20.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.379/2019 të datës 05.07.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga

në Prishtinë, kundër heshtjes administrative të Komisionit për Shtesa të Teknologjisë Informative të Ministrisë së Administratës Publike, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 29.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.379/2019 e datës 05.07.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. Prot:78 të datës 01.02.2015 në pozitën "Menaxher i Teknologjisë Informative" në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, më datë 19.04.2019 ka parashtruar kërkesë për njohjen e plotë të shtesës së TI-së tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa më datë 07.05.2019 ka parashtruar kërkesë për njohjen e plotë të shtesës së TI-së tek Komisioni për Shtesa të Teknologjisë Informative në Ministrinë e Administratës Publike.

Komisionin për Shqyrtimin e Shtesave të Fushës së Teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut i Ministrisë së Administratës Publike nuk ka shqyrtuar kërkesën e ankuesit.

Ankuesi kundër heshtjes administrative të Komisioni për Shtesa të Teknologjisë Informative në Ministrinë e Administratës Publike, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3047/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 15.07.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Më datë 22.07.2019 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka dërguar përgjigjen në ankesë, ndërsa me datë 24.07.2019 Ministria e Administratës Publike ka dërguar Vendimin e datës 05.12.2018 për emërimin e Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave të Fushës së Teknologjisë Informative dhe Inixhineringut i Ministrisë së Administratës Publike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mungesë të kuorumit për vendosje nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi më datë 21.08.2019 është njoftuar për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke e udhëzuar që pala mund të fillon konfliktin administrativ në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative, kështu që ankuesi ka vazhduar me hapjen e konfliktit në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 20.06.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.216/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar njoftimin e Këshillit të datës 21.08.2019 dhe duke e detyruar Këshillin që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 05.07.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.07.2019 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 3047/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për njohjen e plotë të shtesës së TI-së me Nr. Prot:1573 të datës 07.05.2019; Akt Emërimin e datës 10.02.2015 të ankuesit; Diplomën me Nr. 192-02/8-17 të ankuesit; Certifikatat e ankuesit prill 2016, mars 2016, qershor 2008, mars 2006, shtator 2001, shkurt 2002, shkurt 2001, shtator 2000, shtator 2011, 31.03.2009, 23.09.2002; Përshkrimin e detyrave të punës për Menaxher i Teknologjisë Informative; Vendimin Nr. 02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Ankesi I; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë; Listën e pagave për muajin janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor 2019 për ankuesin nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; PCF2 nga Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave; Formuari i shpenzimit të departamentit, divizioni ose sektorit; Kërkesa për njohjen e plotë të shtesës së TI-së e datës 19.04.2019 e parashtruar nga ankuesi për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; Vendimin me Nr. Prot:3571 të datës 05.12.2018 për emërimin e Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave të Fushës së Teknologjisë Informative dhe Inixhineringut i Ministrisë së Administratës Publike dhe Përgjigjen në ankesë e datës 22.07.2019 nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe e datës 24.07.2019 nga Ministria e Administratës Publike; Njoftimin e datës 21.08.2019 për ankuesin; Komunikimet me email të datës 18.02.2021 dhe 24.02.2021; Aktgjykimin

A.nr.216/20 të datës 20.06.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitive për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme

në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.379/2019

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

